



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

V E N D I M

Nr. 02 datë 13.01.2022

**MIRATIMI I NIVELIT TË PAGAVE TË BASHKISË DIBËR DHE  
INSTITUCIONEVE TË VARËSISË PËR VITIN 2022.**

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015, “ Për vetëqeverisjen vendore ” dhe në VKM nr. 165 datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nënpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar me VKM nr.177 datë 08.03.2017. Gjithashtu duke u mbështetur edhe në VKM nr.717 datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nënpunësve të disa institucioneve buxhetore”, i ndryshuar me VKM nr. 202 datë 15.03.2017, si dhe në vendimin nr.175 datë 08.03.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”: Këshilli Bashkiak vendosi me datë **13.01.2022** unanimisht.

VENDOSI:

1. Miratimin e nivelit të pagave të Bashkisë Dibër dhe institucioneve në varësi të saj, bazuar në VKM nr. 165 datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nënpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar me VKM nr.177 datë 08.03.2017.
2. Këshilltarët të shpërblehen në masën 10% të pagës së Kryetarit të Bashkisë Dibër, ndërsa kryetarët e fshatrave të shpërblehen në masën:

- 4.4% të pagës së Administratorit {5.000-20.000 banorë } (0-300) banorë
- 6% të pagës së Administratorit {5.000-20.000 banorë } (301-600) banorë
- 7% të pagës së Administratorit {5.000-20.000 banorë } (601-1000) banorë
- 9% të pagës së Administratorit {5.000-20.000 banorë } (+1000) banorë

- 6% të pagës së Administratorit {0-5000 banorë } (0-300) banorë
- 8% të pagës së Administratorit {0-5000 banorë } (301-600) banorë
- 9% të pagës së Administratorit {0-5000 banorë } (601-1000) banorë
- 10% të pagës së Administratorit {0-5000 banorë } (+1000) banorë


3. Me zbatimin e këtij vendimi do të merret Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse (Sektori i Personelit) dhe Drejtoria Ekonomike (Sektori i Financës) pranë Bashkisë Dibër.

4. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit dhe konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Dibër ku efektet financiare i shtrin sipas përcaktimit të VKM.

5. Vendimi u shpall sot me date **13.01.2022**

Kryetar Këshilli

Sokol SAVA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.52/1.prot.

Peshkopi, më 21.01.2022

Lënda : Per vendimin nr. 02, datë 13.01.2022 të Këshillit të Bashkisë Dibë

Drejtuar : BASHKISE DIBER

PESHKOPI

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër nr.02, date 13.01.2022 “Për miratimin e nivelit të pagave të Bashkisë Diber dhe institucioneve të varësisë për vitin 2022”, konstatova se :

Në këndvështrim të nenit 54, shkronja “ç”, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, këshilli i bashkisë gëzon të drejtën e miratimit të *“nivelit të pagave e të shpërblimeve të punonjësve e të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emruar, në përputhje me legjilacionin në fuqi”*.

1.Parë problemin në kuptim të dispozitës së lartëcituar, këshilli i bashkise miraton nivelin e pagave e të shpërblimeve të punonjësve që janë zgjedhur (funksione politike) dhe ato që janë emruar ku marrëdhëniet e punësimit rregullohen nga Kodi i Punës.

2.E drejta dhe kompetenca për miratimin e *“strukturës, organikës e kategoritë / klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil....., në përputhje me legjilacionin në fuqi”*, në kuptim të nenit 64, shkronja “j” të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” është e Kryetarit të Bashkisë.

Një vendimmarrje e tillë e marrë nga kryetari i bashkisë në formën e urdherit apo vendimit duhet të depozitohet tek Prefekti për verifikimi ligjshmërie , pasi bën pjesë në kategorinë e akteve me karakter normativ.

Duke miratuar në parim vendimin objekt verifikimi dhe shqyrtimi, kërkohet të përcillet prane nesh urdheri i Kryetarit të Bashkise , ku të përfshihet çdo qelizë e shërbimit civil (struktura, organika per secilin drejtori / sektor apo zyrë, klasat/pagat në përputhje me legjilacionin në fuqi.

